

AKT-THEMELIMI
I
SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ICEBERG ”SH.P.K.

KREU I

NENI 1

Krijimi

Mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi , në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqërite Tregtare" dhe në zbatim me ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"; ligjit nr.129/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare " të ndryshuar , sot në datën **06/10/2022**, bëhet themelimi i shoqërisë **“ICEBERG” SH.P.K** me seli **Tiranë, Rruga Mine Peza, pasuria numer 4/63-N3, zona kadastrale 8350, volumi 34, faqe 241**, nga ortaku i kësaj Shoqërie 100 % **Z.Memet Çuroj**, i pajisur me kartë identiteti me numër personal **J70927045Q**.

NENI 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria “ICEBERG” shpk, është një e tillë, kapitali i secilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku I vetëm që përballon humbje deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

NENI 3

Selia

Shoqëria e ka selinë e saj në:

Tirane, Rruga Mine Peza, pasuria numer 4/63-N3, zona kadastrale 8350, volumi 34, faqe 241

Ajo mund të hapë përfaqësi, degë ose filiale edhe në qytete të tjera të Shqipërisë.

NENI 4
Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj me objekt si më poshtë :

- 1- Aktivitet në fushën e këmbimit valutor.
- 2- Agjent i shoqërisë EASY PAY (institucion i parasë elektronike) për kryrjen e shërbimeve që përfshijnë , por nuk kufizohen në pagesa faturash dhe transfertash bankare.
- 3- Shitje biletash të transportit kombëtar dhe ndërkombëtar të linjave ajrore, detare dhe tokësore etj.
- 4- Dhenie dhe marrjen automjetesh me qira, siguracione automjetesh.. etj.,

NENI 5
Kohëzgjatja

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë i pakufizuar, me përjashtim të rastit kur ortakët vendosin prishjen e saj.

KREU II
KAPITALI

NENI 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë përfaqëson kontributet në para dhe është **2.500.000** (dy milion e pesëqind mijë) lekë shqiptare dhe i ndarë në 1 (një) pjesë të vetme. Ortaku **Z.Memet Çuroj** zotëron një kuotë me vlerë **2.500.000 lekë** ose **100 %** të kapitalit themeltar.

NENI 7
Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Ortakut të Vetëm.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë të transferueshme edhe në rast ndarje pasurore midis bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU III ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

NENI 8 Organi Vendimmarrës

Ortaku i Vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
Ortaku i Vetëm është organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
Ortaku i Vetëm brenda një afati prej gjashtë muajsh , duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin bilancin dhe llogaritë vjetore të hartuara nga administratori.

NENI 9 Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga ortaku i vetëm.
Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

NENI 10 Administrimi

Administratori i shoqërisë është **Memet Çuroj, nga periudha 06.10.2022 deri më 06.10.2027**

Administratori mund të shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

NENI 11 Kompetencat

Shoqëria administrohet nga një Administrator i Vetëm. Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë , juridikë, publikë dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Administratori ka gjithashtu të drejtë të nënshkruajë kontrata të ndryshme në emër e për llogari të shoqërisë, përfshirë këtu kontratat e qirasë, blerjes apo hipotekimi të

pasurive të paluajtshme , të nënshkruajë aktet e themelimit të shoqërive të tjera ku Shoqëria është ortak , të nënshkruajë e hartojë çdo dokument e të kryejë në emër të Shoqërisë çdo veprim përballë të gjitha Bankave shqiptare apo të huaja në lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse të Shoqërisë, nënshkrimin e kontratave të ndryshme bankare për financimin e Shoqërisë si dhe të kryejë veprime tërheqje e derdhje shumash nga këto llogari pa limit.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij akt themelimi që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratorit ose ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohej të kontraktojnë në çfarëdo lloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzanës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

NENI 12

Viti financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

NENI 13

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar siç mund të jenë :

- a) Humbja e Kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të veprimtarisë së saj.
- b) Në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji “Për falimentimin e Shoqërive Tregtare”
- c) Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në këtë rast Ortaku i Vetëm merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”

NENI 14

Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat në fuqi të legjislacionit shqiptar.

Përsa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 15

Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi përpilohet në 3 kopje me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku themelues I shoqërisë tregtare “ICEBERG” shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale.

THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE

“ICEBERG ” SH.P.K

Memet Çuroj

Memet Çuroj



Tiranë më 06.10.2022.